



NR. 392/KU
DATE 31.01.2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 119/ Prot.

Tiranë më, 30.01.2023

Lënda: Kthim përgjigje.

Z. ILIRIAN CELIBASHI
KOMISIONER SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI QËNDROR I ZGJEDHJEVE

TIRANË

I nderuar Z.Celibashi,

Në përgjigje të kërkesës/shkresës tuaj nr.392, datë 25.01.2023 “Kërkesë për informacion”, lidhur me numrin e procedimeve të regjistruara në fushën e zgjedhjeve, personat nën hetim, të dhënat për kërkesat e prokurorisë për gjykim, numrin e personave të dënuar për vitin 2021 dhe 2022, etj;

Në mbështetje të nenit 107/1 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ju dërgojmë të dhënat statistikore për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325 deri 332/a të Kodit Penal, për vitin 2021 dhe 9 mujorin 2022 (në mungesë të të dhënave për vitin 2022), përkatësisht në tabelat Aneksi 1 dhe Aneksi 2, bashkëlidhur. Sqarojmë se të dhënat statistikore për vitin 2022 janë në fazën e mbledhjes nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe përpunimit tyre, të cilat do t’jua dërgojmë menjëherë sapo të përfundoj ky proces.

Në këtë dy tabelat bashkëlidhur janë pasqyruar të dhënat statistikore për vitin 2021 dhe 9 mujorin 2022 me treguesit në shifra për veprat penale përkatëse dhe totali/gjithsejt: -regjistruar procedime penale dhe të pandehur, -kërkesa/procedime për gjykim dhe të pandehur, -persona të dënuar, -mbetura në gjykim çështje dhe të pandehur, si dhe -tregues me të dhëna për të pandehurit, ku përfshihen, -gjinia, -mosha, -arsimi, -gjendja shoqërore, -vendbanimi, dhe -gjendja gjyqësore.

Lidhur me kohëzgjatjen e hetimit, bazuar në të dhënat statistikore sqarojmë se, për vitin 2021 janë ndjekur me zgjatje afati (3 muaj deri në 6 muaj) 2 (dy) procedime penale, ndërsa për 9 mujorin 2022 nuk ka procedime të ndjekura me zgjatje afati. Ndërsa, të dhëna për kohëzgjatjen e gjykimit nuk administrohen në statistikat e sistemit të prokurorisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



